



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDËRMARRJA SHËRBIMEVE KOMUNALE DURRËS

NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot

Durrës, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kazanë për mbetje urbane”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44613700-7

NUMRI I REFERENCËS SË PROCEDURËS: REF – 97717-08-26-2026

VLERA E FONDIT LIMIT: 6.660.000 (gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë)
lekë pa Tvsh.

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe studimit të tregut, fondi limit u përlogarit bazuar në mesataren e cmimeve të marra nga ky studim.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Shërbimeve Komunale Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: *"...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik..."*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP *"Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit në SPE, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 te ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në pikën 2/b citohet: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndersa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu vendosja e kriterëve në reference është bërë që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët,

nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/b, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar me Ligji nr. 16/2024, si dhe në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, i cili rregullon kriteret për procedurat e hapura të thjeshtuara.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë përvojën e nevojshme për realizimin e kontratës. Për këtë arsye, është kërkuar që përvoja e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit, në përputhje me kufijtë e përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Përcaktimi i kësaj vlere është bërë në mënyrë proporcionale, duke marrë në konsideratë natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e kontratës objekt prokurimi, me qëllim garantimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë që zotërojnë kapacitetin teknik dhe përvojën e nevojshme për realizimin e saj. Njëkohësisht, kjo kërkesë nuk tejkalon nivelin e nevojshëm dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi është vendosur brenda marzheve të lejuara nga legjislacioni përkatës dhe u jep mundësi pjesëmarrjeje një game të gjerë operatorësh ekonomikë. Në këtë mënyrë, kriteri për kontrata të ngjashme shërben si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e aftësisë teknike të operatorëve ekonomikë, duke garantuar një proces prokurimi të drejtë, transparent dhe efektiv.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë prova që vërtetojnë aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës.

Deklarata me anë të së cilës operatori ekonomik merr përsipër të kryejë transportin e mallrave me shpenzimet e veta deri në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore, kërkohet për të garantuar përmbushjen e plotë të detyrimeve kontraktore dhe furnizimin e mallrave në vendin e dorëzimit, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcional me natyrën dhe vlerën e kontratës, nuk krijon kufizime të pajustificuara për konkurrencën dhe siguron që ofertuesi të ketë kapacitetin organizativ për të realizuar shpërndarjen e mallrave në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës.

3. Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të disponojë **të paktën 1(një)** automjet per transportin e mallrave, të cilin duhet t'i ketë në pronësi, me qira ose perdorim.

Per sa me siper operatori ekonomik ofertues te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi ,ose qira, ose perdorim

Shenim 3.1: Per mjetet me status perdorimi qira ose hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve. Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin dokumentacionin e mesiperm prane Autoritetit Kontraktor jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar.

Ky kriter quhet i permbushur me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9, dhe ne baze të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, sipas të cilit: “6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike...”

Argumentim: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 4 të Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligji nr. 16/2024, si dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, me qëllim që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion apo mund t’u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për përmbushjen e kontratës. Kërkesa për këto mjete dhe pajisje është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, konkretisht me nevojën për transportin dhe shpërndarjen e materialeve të pastrimit në adresat e autoriteteve kontraktore, duke garantuar realizimin korrekt dhe në kohë të shërbimit. Në këtë

mënyrë, përdorimi i Formularit të Vetëdeklarimit (Shtojca 9) në fazën e ofertimit lehtëson pjesëmarrjen dhe redukton barrën administrative për operatorët ekonomikë, ndërsa kërkesa për paraqitjen e dokumenteve provuese në fazën e vlerësimit përfundimtar siguron verifikimin e plotë të kapaciteteve të deklaruara, në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur në fazën e ofertimit me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, në përputhje me nenin 26, pika 1 dhe pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, ku parashikohet se autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake vetëdeklarimin e operatorit ekonomik në vend të dokumenteve të lëshuara nga autoritetet publike apo palë të treta. Pra, operatorët ekonomikë, në momentin e paraqitjes së ofertës, duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9), duke deklaruar përmbushjen e kriterëve të kërkuara, përfshirë edhe disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari paraqitjen e dokumenteve provuese që vërtetojnë saktësinë e vetëdeklarimit, si dhe dokumentacionin shoqërues të ofertës, të dorëzuar në rrugë elektronike.

4. OE duhet të paraqesë në SPE Autorizim prodhuesi ose Distributor i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e ofertuara. Në rastet e autorizimit nga distributori, duhet të vërtetohet lidhja që distributori ka me prodhuesin. Në autorizim duhet të jete i paraqitur Nr. i referencës së procedurës së prokurimit si dhe të dhëna të sakta të Prodhuesit/Distributorit në mënyrë që AK të ketë mundësi të kryej verifikimet e nevojshme.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 në Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjisllacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Kërkesa që në autorizim të pasqyrohet numri i referencës së procedurës së prokurimit është e nevojshme dhe proporcionale,

pasi garanton që autorizimi është lëshuar specifikisht për këtë procedurë prokurimi dhe jo një autorizim i përgjithshëm, i papërcaktuar apo i përdorur njëkohësisht në procedura të ndryshme.

Ky element i shërben autoritetit kontraktor që të verifikojë autenticitetin dhe vlefshmërinë e autorizimit; të sigurojë lidhjen direkte të prodhuesit/distributorit me procedurën konkrete të prokurimit; të shmangë paraqitjen e autorizimeve të përgjithshme, të pavlefshme ose të ripërdorura; të garantojë gjurmueshmërinë dhe transparencën e dokumentacionit të paraqitur; të krijojë mundësinë për kryerjen e verifikimeve administrative pranë prodhuesit/distributorit; garantimin e seriozitetit të ofertës dhe sigurimin e furnizimit me mallrat e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në SPE Deklaratë në të cilën të marrë përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike duke cilesuar për çdo produkt sipas kërkesave të AK si dhe realizimin e kontratës sipas afatit 20 ditor.

Argumentim: Në bazë të nenit 36 në Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të siguruar nëse operatori ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas kërkesave dhe specifikimeve.

Përcaktimi i afatit prej 20 ditësh për lëvrimin e mallit është i nevojshëm dhe i justifikuar nga natyra e furnizimit objekt prokurimi, pasi kazanët për mbetjet urbane janë mjete të nevojshme për garantimin e vazhdimësisë dhe funksionimit normal të shërbimit. Nevoja për kazanë lidhet me kërkesat e shërbimit dhe me periudhat/sezonet e përdorimit, ndërkohë që një pjesë e tyre nevojiten për mbulimin e nevojave të sezonit aktual. Për këtë arsye, furnizimi duhet të realizohet brenda një afati të arsyeshëm dhe të përshtatshëm me nevojat e Autoritetit Kontraktor.

Afati 20-ditor është përcaktuar me qëllim që të sigurohet furnizimi në kohë, pa krijuar vonesa që mund të ndikojnë në vijimësinë dhe cilësinë e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane, duke garantuar njëkohësisht që Operatori Ekonomik të ketë një afat të përshtatshëm për realizimin e furnizimit sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

6. Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikatë ISO 9001:2015 të prodhuesit, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë dhe /ose të njëvlefshme, të cilat do të garantojnë cilësinë e produktit ose standart ISO më të avancuar, e perkthyer e noterizuar. Çertifikata duhet të jetë e

vlefshme dhe e lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues.

Ne Çertifikatën ISO 9001:2015 duhet të jete e përfshirë Objekti i prokurimit.

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e Çertifikatës ISO 9001:2015 të prodhuesit, ose të një standardi ekuivalent/më të avancuar, është përcaktuar në funksion të natyrës dhe destinacionit të mallrave objekt prokurimi, konkretisht kazanëve për mbetje urbane. Në përputhje me nenin 40 dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, autoriteti kontraktor ka të drejtë të përcaktojë kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, si dhe kërkesa teknike që lidhen me cilësinë, performancën dhe përputhshmërinë e mallrave objekt prokurimi, me qëllim garantimin e realizimit të kontratës sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Neni 77 i Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe neni 40 i VKM nr. 285/2021, të ndryshuar, lidhur me kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional dhe dëshmitë që mund të kërkojnë nga Autoriteti Kontraktor

Kazanët do të përdoren në mënyrë të vazhdueshme në kuadër të shërbimit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane dhe do t'i nënshtrohen përdorimit të përsëritur dhe kushteve të ndryshme të shërbimit. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka nevojë të sigurohet se prodhuesi i produkteve të ofruara disponon një sistem të dokumentuar të menaxhimit të cilësisë dhe procese të kontrolluara për prodhimin e tyre. Kërkesa që objekti/fusha e çertifikatës të lidhet me prodhimin e produkteve objekt prokurimi synon të sigurojë që çertifikimi të ketë lidhje reale me aktivitetin dhe produktin që do të furnizohet. Kërkesa për vlefshmërinë e çertifikatës dhe lëshimin e saj nga organizma të akredituar synon të sigurojë autenticitetin, besueshmërinë dhe verifikueshmërinë e dokumentacionit të paraqitur. Kriteri është vendosur duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe lidhjes me objektin e kontratës, pasi lidhet drejtpërdrejt me sigurimin e cilësisë së procesit të prodhimit të kazanëve që do të furnizohen.

7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në SPE: Deklaratë Konformiteti (Declaration of Conformity) të prodhuesit për kontejnerët e ofruar

Argumentim:Kërkesa për paraqitjen e Deklaratës së Konformitetit të prodhuesit për kazanët e ofruar është përcaktuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të disponojë një dokument të lëshuar

nga prodhuesi, nëpërmjet të cilit deklarohet përputhshmëria e produktit me kërkesat dhe standardet e aplikueshme. Kji kërkesë është e bazuar në nenin 77 i Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, si dhe dispozitat e VKM nr. 285/2021, të ndryshuar, që lejojnë Autoritetin Kontraktor të kërkojë dokumente dhe dëshmi të lidhura me aftësinë teknike/profesionale dhe përmbushjen e kërkesave teknike të mallrave.

Duke qenë se objekti i prokurimit është blerja e kazanëve për mbetje urbane, të cilët duhet të përmbushin një sërë kërkesash teknike dhe funksionale, Deklarata e Konformitetit shërben si dokument plotësues për identifikimin dhe verifikimin se produkti i ofruar është konform standarteve europiane. Kërkesa mundëson gjithashtu lidhjen ndërmjet prodhuesit, modelit konkret të produktit dhe dokumentacionit teknik të paraqitur nga ofertuesi, duke rritur gjurmueshmërinë dhe sigurinë në procesin e vlerësimit të ofertave. Kjo kërkesë nuk vendos një kufizim të panevojshëm për konkurrencën, pasi synon vetëm të dokumentojë përputhshmërinë e produktit konkret të ofruar me kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor.

8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në SPE: Raporte testimi të lëshuara nga një organ/laborator kompetent, që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet:

- EN 840-5:2020;
- EN 840-6:2020.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në SPE: Dokument që provon akreditimin e organit që ka lëshuar raportet e testimit, i vlefshëm në datën e dorëzimit të ofertës, së bashku me fushën (Scope of Accreditation), nga e cila të rezultojë se mbulohen testimet sipas standardeve EN 840.

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e raporteve të testimit sipas standardeve EN 840-5:2020 dhe EN 840-6:2020 është përcaktuar në funksion të natyrës së produktit objekt prokurimi dhe nevojës së Autoritetit Kontraktor për të verifikuar në mënyrë objektive përputhshmërinë e kazanëve të ofruar me standardet teknike të përcaktuara. Kjo është e bazuar në nenin 77 i Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, si dhe dispozitat e VKM nr. 285/2021, të ndryshuar, lidhur me kërkesat teknike dhe profesionale dhe mënyrën e dëshmimit të përputhshmërisë së mallrave.

Kazanët për mbetje urbane janë produkte që do të përdoren në mënyrë të përsëritur dhe do t'i nënshtrohen proceseve të grumbullimit dhe evadimit të mbetjeve. Për këtë arsye, verifikimi i karakteristikave të tyre nëpërmjet raporteve të testimit përbën një element të rëndësishëm për

vlerësimin e përshtatshmërisë së produktit. Raportet e testimit të lëshuara nga një laborator/organ kompetent i japin Autoritetit Kontraktor një bazë objektive për të verifikuar përmbushjen e kërkesave teknike, përtej deklarimeve të vetë operatorit ekonomik.

Kërkesa që organi/laboratori të jetë i akredituar dhe që të paraqitet edhe Scope of Accreditation, synon të sigurojë se testimet janë kryer nga një subjekt kompetent dhe se fusha e akreditimit përfshin testimet përkatëse sipas standardeve EN 840. Ky kriter është drejtpërdrejt i lidhur me objektin e kontratës dhe është përcaktuar për të garantuar që kazanët e furnizuar të jenë teknikisht të përshtatshëm për përdorimin e synuar.

9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në SPE skedën teknike të produktit, katalogun e prodhuesit ose fragmentet përkatëse të katalogut, si dhe fotografi të produktit të ofruar, nga të cilat të identifikohen qartë prodhuesi, marka, modeli, dimensionet, kapaciteti dhe karakteristikat teknike të produktit. Dokumentacioni teknik i paraqitur duhet të vërtetojë përputhshmërinë e plotë të produktit me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

- Të gjitha dokumentet e lëshuara në gjuhë të huaj të paraqiten të shoqëruara me përkthim zyrtar në gjuhën shqipe, sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentim: Kjo kërkesë është e bazuar në nenin 77 i Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, dhe dispozitat përkatëse të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar, lidhur me kapacitetin teknik/profesional dhe dokumentacionin që mund të kërkohet për verifikimin e përputhshmërisë së mallrave. Kërkesa për paraqitjen e skedës teknike, katalogut të prodhuesit dhe fotografive të produktit është përcaktuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të mund të identifikojë qartë produktin konkret të ofruar dhe të verifikojë përputhshmërinë e tij me specifikimet teknike.

Për shkak se në treg ekzistojnë kazanë për mbetje urbane me modele, dimensione, kapacitete dhe karakteristika të ndryshme, identifikimi i saktë i produktit është i domosdoshëm për të shmangur paqartësitë gjatë vlerësimit të ofertave. Dokumentacioni i kërkuar duhet të mundësojë identifikimin e prodhuesit, markës, modelit, dimensioneve, kapacitetit dhe karakteristikave të tjera teknike, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësi të bëjë krahasimin ndërmjet produktit të ofertuar dhe kërkesave të kërkuara prej tij. Kjo kërkesë është proporcionale me objektin e prokurimit dhe lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të siguruar që malli i ofertuar dhe më pas i furnizuar të jetë pikërisht ai produkt që është vlerësuar dhe pranuar gjatë procedurës.

10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një (1) mostër të produktit të ofruar në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor. Mostra duhet të jetë identike me produktin e ofertuar në SPE.

- Mostra duhet të shoqërohet me etiketën ose pllakën identifikuese të prodhuesit, ku të evidentohen marka, modeli, kapaciteti dhe, nëse aplikohet, data e prodhimit ose numri serial.
- Mosparaqitja e mostrës brenda afatit të përcaktuar përbën shkak për skualifikimin e ofertës. Mostra do të përdoret nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike të kërkuara.
- Në rast se dokumentacioni teknik i paraqitur nuk provon përputhshmërinë e produktit me specifikimet teknike të kërkuara, ose konstatohet mospërputhje ndërmjet dokumentacionit teknik dhe mostrës së paraqitur dhe specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, oferta do të konsiderohet e papranueshme dhe do të refuzohet.

Argumentim: Kjo kërkesë është e bazuar në nenin 40, pika 6, shkronja “a”, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, i cili parashikon mundësinë që Autoriteti/enti kontraktor t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë mostra të mallit, kur gjykohet se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Kërkesa për paraqitjen e një mostre të produktit të ofruar është përcaktuar duke pasur parasysh natyrën e objektit të prokurimit, konkretisht blerjen e kazanëve për mbetje urbane, dhe faktin se karakteristikat e tyre teknike dhe fizike mund të verifikohen drejtpërdrejt nëpërmjet ekzaminimit të produktit. Mostra i jep mundësi Autoritetit Kontraktor të verifikojë në mënyrë konkrete përputhshmërinë e produktit të ofruar me specifikimet teknike, përfshirë, sipas rastit, dimensionet, kapacitetin, materialin, konstruksionin, elementët funksionalë, përfundimin dhe karakteristika të tjera të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Kërkesa që mostra të jetë identike me produktin e ofertuar në SPE synon të sigurojë lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet produktit fizik, dokumentacionit teknik dhe ofertës së paraqitur nga Operatori Ekonomik. Etiketa ose pllaka identifikuese e prodhuesit shërben për identifikimin dhe gjurmueshmërinë e mostrës dhe për të mundësuar krahasimin e saj me dokumentacionin teknik të paraqitur. Mosparaqitja e mostrës brenda afatit të përcaktuar sjell pamundësinë e kryerjes së këtij verifikimi teknik, për rrjedhojë konsiderohet mospërmbushje e kërkesës së përcaktuar në

dokumentet e tenderit. Në rast konstatimi të mospërputhjes ndërmjet mostrës, dokumentacionit teknik dhe specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor nuk mund të sigurohet që produkti i ofruar përmbush kërkesat e përcaktuara, ndaj oferta trajtohet në përputhje me parashikimet e dokumenteve të tenderit.

Kërkesa për mostër është vendosur në mënyrë proporcionale me objektin e kontratës dhe ka si qëllim të vetëm verifikimin e përputhshmërisë së produktit të ofertuar me kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM:

Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".


Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

1.Specifikime per “Kazane plastik per mbetje urbane me kapacitet 1100 Litra”



- Kazane plastik për mbetje urbane me kapacitet 1100 litra,
- Dimensionet ($\pm 2\%$)
 - Gjerësi totale: 1390 mm
 - Gjerësi kapaku: 1190 mm
 - Gjatësi: 1080 mm
 - Lartësi totale: 1330 mm
 - Lartësi trupi: 1220 mm
 - Lartësi deri në bosht: 775 mm
 - Distanca rrotash (ballore): 850 mm
 - Distanca rrotash (anësore): 740 mm
 - Diametri rrotave: 200 mm
- Materiali
 - HDPE (Polietilen me densitet të lartë), rezistent ndaj UV, temperaturave (-20°C deri $+40^{\circ}\text{C}$), dhe kimikateve.
- Pesha
 - Pesha vetjake: 50 – 65 kg
- Kapaku
 - Kapak i fortë HDPE, i lidhur me trupin, rezistent ndaj goditjeve dhe kushteve atmosferike.
- Dorezat
 - Doreza ergonomike të integruara në trup për manovrim të lehtë.
 - Doreza të përforcuara për ngritje dhe zhvendosje.
- Rrotat
 - 4 rrota rrotulluese 360°
 - Diametër: 200 mm
 - Material: gomë e fortë / poliuretan

- 2 rrota me sistem frenimi
- Kapaciteti dhe ngarkesa
- Kapacitet: 1100 litra
- Ngarkesa maksimale: ≥ 400 kg
- Karakteristika shtesë
- Vrima kullimi me tapë
- Sipërfaqe e lëmuar për pastrim
- Rezistencë ndaj korrozionit
- Kazani plastik duhet të ketë mbishkrimin sensibilizues me logo si me poshtë:



- Ngjyra do të përcaktohet në momentin e lidhjes së kontratës, sipas kërkesave të AK.




Foto ilustruese




Foto ilustruese




Foto ilustruese

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar., duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet Teknike gjenden ne shtojcen 6 te Dokumentave Standarte te Tenderit.

Argumentimi teknik : Specifikimet teknike për kazanët për mbetje urbane, objekt i kësaj procedure prokurimi, janë hartuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për prokurimin publik, duke respektuar parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Ato janë konceptuar duke përcaktuar kërkesat minimale teknike, funksionale dhe të cilësisë që duhet të përmbushin produktet, me qëllim garantimin e përshtatshmërisë së tyre për përdorimin e synuar dhe sigurimin e një shërbimi të qëndrueshëm të grumbullimit të mbetjeve urbane.

Përcaktimi i këtyre kërkesave është bërë në bazë të nevojave konkrete të Autoritetit Kontraktor dhe të natyrës së shërbimit të menaxhimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane, ku kazanët përbëjnë një element të rëndësishëm të infrastrukturës së këtij shërbimi. Për shkak të përdorimit të përditshëm dhe intensiv, kazanët duhet të jenë të përshtatshëm për përdorim të vazhdueshëm, mbledhje dhe evadim të mbetjeve, si dhe për përdorim në ambiente të jashtme dhe në kushte të ndryshme atmosferike. Në këtë kuadër, kërkesat teknike janë orientuar drejt sigurimit të kazanëve me material dhe konstruksion të përshtatshëm, rezistent ndaj konsumimit dhe përdorimit të përsëritur, me kapacitet dhe përmasa të përshtatshme për nevojat e Autoritetit Kontraktor. Kërkesat për karakteristikat fizike dhe funksionale të kazanëve synojnë të garantojnë që produktet të jenë të qëndrueshme, të sigurta dhe praktike gjatë përdorimit, manipulimit dhe zbrazjes së tyre. Përcaktimi i kërkesave për dimensionet, kapacitetin, materialin, konstruksionin, kapakun, rrotat, dorezat dhe elementët e tjerë funksionalë është bërë në funksion të përdorimit të kazanëve në shërbimin e grumbullimit të mbetjeve urbane. Këto karakteristika ndikojnë drejtpërdrejt në lehtësinë e manipulimit, qëndrueshmërinë e produktit, sigurinë gjatë përdorimit dhe jetëgjatësinë e tij. Specifikimet teknike janë përcaktuar në nivelin minimal të nevojshëm për

përmbushjen e qëllimit të kontratës dhe nuk synojnë të favorizojnë një produkt, prodhues apo operator ekonomik të caktuar. Ato janë hartuar në mënyrë të tillë që të lejojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që mund të ofrojnë produkte të ndryshme, për sa kohë që ato përmbushin kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në rastet kur specifikimet teknike i referohen standardeve të caktuara, referimi shoqërohet me mundësinë e ofrimit të standardeve ose produkteve ekuivalente, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, duke garantuar konkurrencë të gjerë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë. Kërkesat teknike për materialin, kapacitetin, dimensionet, qëndrueshmërinë dhe elementët funksionalë janë përcaktuar duke marrë në konsideratë përdorimin intensiv të kazanëve dhe nevojën për të minimizuar dëmtimet, deformimet dhe zëvendësimet e shpeshta gjatë periudhës së përdorimit. Në këtë mënyrë synohet që Autoriteti Kontraktor të sigurojë një produkt me jetëgjatësi dhe performancë të përshtatshme për nevojat e shërbimit. Gjithashtu, përcaktimi i specifikimeve teknike synon të sigurojë që kazanët të jenë të përshtatshëm për përdorim në kushtet reale të shërbimit të pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane, duke garantuar njëkohësisht sigurinë e punonjësve që merren me manipulimin e tyre dhe funksionalitetin gjatë procesit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.

Specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e nevojave reale të Autoritetit Kontraktor dhe të funksionit që duhet të përmbushin kazanët për mbetje urbane. Çdo kërkesë teknike lidhet drejtpërdrejt me cilësinë, sigurinë, qëndrueshmërinë, funksionalitetin dhe jetëgjatësinë e produktit dhe nuk tejkalon nivelin e nevojshëm për realizimin e qëllimit të kontratës. Në këtë mënyrë, specifikimet teknike krijojnë një bazë të qartë dhe objektive për vlerësimin e ofertave dhe për garantimin e furnizimit me kazanë cilësorë, të përshtatshëm për përdorim të përditshëm dhe intensiv në kuadër të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane, duke respektuar njëkohësisht parimet e konkurrencës së lirë, proporcionalitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit.